



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 01 datë 08/02/1996

Këshilli Bashkiak i Tiranës, i mbledhur sot me dt.08.02.1996, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike mbi organizimin e punonjësve të Kuartalleve për pastrimin e territoreve midis pallateve :

V E N D O S I

1. Të krijohet Ndërmarrja e Pastrimit të Kuartalleve N.P.K.
2. Objekti i kësaj ndërmarrjeje do të jetë pastrimi i territoreve midis pallateve dhe zonave të reja të banimit që i shtohen Bashkisë së Tiranës si Kodër Kamëz, Bregu i Lumit, Sauku, Kodra e Priftit si dhe heqja e dherave, skeleteve të makinave, vrasjes së qenëve rrugaçë si dhe pastrimi i rrugëve të treta.
3. Fuqia punëtore e kësaj ndërmarrjeje do të krijohet nga forcat punëtore e ish dy Ndërmarrjeve të Pastrimit Nr.1 dhe Nr.2 me një shtesë prej 20 punonjësish, pra gjithsej 220 punonjës me një pagë mesatare prej 5.900 lekë në muaj.
4. Nën administrimin e kësaj ndërmarrjeje do të jenë zyrat, ambjentet, pajisjet dhe makineritë e ish Ndërmarrjes të Pastrimit Nr.2.
5. Të çelen nga të ardhurat e Bashkisë për vitin 1996 fondi prej 33.000 mijë lekë për Ndërmarrjen e Pastrimit të Kuartalleve.(N.P.K.)
6. Aktiviteti i kësaj ndërmarrjeje do të fillojë me 1 Janar 1996.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen : Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria Administrimit Financiar.

K R Y E T A R I

BESNIK PETRELA